



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dop. Dop.	2-D/DPK
Nr. i treg. Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Bi Prot. Prot No.	01-410/14
Data Datum Date	31.01.2014



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 28.01.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-2774/13, për z. Nijazi Ukshini – ish Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Vitisë, për arsye se i njëjti tashmë nuk e ushtron funksionin e zyrtarit të lartë publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-2774/13, për z. Nijazi Ukshini – ish Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Vitisë, dhe njëkohësisht pronar në biznesin privat N.P.T. “RUDINA”, dhe person i autorizuar në N.T.P. “PAJA” është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në këtë rast, z. Ukshini, së pari është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit lidhur me funksionin e tij publik.

Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari në fjalë, është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë dhe i është sqaruar situata në të cilën ndodhet. Në këtë takim, ai na ka informuar se nuk e ushtron më funksionin e zyrtarit të lartë, përkatësisht Drejtorit të Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Vitisë gjë që vërtetohet edhe me rastin e deklarimit të pasurisë pas largimit nga funksioni (DP. 03/988/14).

Prandaj, duke pasur parasysh këto të dhëna, konstatojmë se gjendja e mundshme e konfliktit të interesit është shmangur.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

